# STATUT
# I
# SHOQËRISË AKSIONARE

## "SKY ALBSLO GROUP" - SHA

# KAPITULLI
# I
# KRIJIMI. FORMA. EMRI. SELIA. KOHËZGJATJA. OBJEKTI

### Neni 1

### Aksionarët Themelues

Aksionerët themelues të shoqërisë **"SKY ALBSLO GROUP" SHA** janë:

**I.1. Z. Ajdin Sejdiu**, i biri i Brahimit dhe Zejnijes, lindur më 21.09.1951 në fshatin Grabanicë, Kosovë, banues në Tiranë, Rruga "Ibrahim Rrugova", Shkalla 1, Ap. 16, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me pasaportë Nr. K 00386145.

**I.2. Z. Remzi Hoti**, i biri i Xhaferrit dhe i Sadies, lindur më 22.01.1967 në Durrës, banues në Durrës, Lagje Nr. 13, Rruga: "Bajram Curri", Plazh, Durrës, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me letërnjoftim Nr.030610302,

### Neni 2
### Forma Ligjore

2.1 Shoqëria krijohet në formën e shoqërisë aksionare, me ofertë private (pa ofertë publike), në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe regjistrohet në bazë të ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007, nenet 26,28,32 e 36 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

### Neni 3
### Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjja nr. 5, Rruga "Maliq Muça", godina private kati parë, pranë Kopshtit Ivina, Durrës.
Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në të gjithë territorin e vendit e jashtë tij, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

**Neni 4**
**Emri**

Emri i shoqërisë është: **"SKY ALBSLO GROUP" - SHA.**

**Neni 5**
**Kohëzgjatja**

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar, duke filluar që nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 6**
**Objekti**

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "SKY ALBSLO GROUP" - SHA është në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe do të jetë :

**6.2** Projektimi dhe ndërtimi i objektive të ndryshme civile, industriale dhe të infrastrukturës.

**6.3** Ndërtime dhe projektime të objekteve tw ndryshme industriale, civile, infrastrukturore, energjitike etj.,

**6.4** Tregetim, import-eksport mallra e materiale te ndryshme industriale, ushqimore, artikuj ndwrtimi etj.

**6.5** Kryerja e operacioneve ekonomike, juridike e financiare si dhe e çdo biznesi që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, brenda kuadrit të dispozitave ligjore .

6.6 Kryerja e çdo operacioni tjeter tregtar, financiar dhe kreditimi. Blerje, shitje ose të marrje me qera tw objekteve tw ndryshme tw luajtshme e tw paluajtshme. Marrja pjesë në shoqëri e në konsorciume të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

6.7 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet apo të shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

6.8 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.

6.9 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë shqiptare ose të huaj që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj.

**KAPITULLI II**
**KAPITALI - AKSIONET**

**Neni 7**
**Kontributet**

7.1 Në çastin e krijimit të shoqërisë, kapitali themeltar i shlyer në lekë është 3.500.000 ( tre milion e peswqind mijw) lekë.

7.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3500 aksione me vlerë nominale prej 1000 (njëmijë) lekë secili. Aksionet janë të pandashme

7.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht prej aksionarëve:

1. **Zoti Ajdin Sejdiu zotëron 51%** (nëntëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar, që i korrespondon 1785 aksioneve, në shumën 1.785.000 (njëmilion shtatëqind tetëdhjetë e pesë mijë) lekë .
2. **Zoti Remzi Hoti zotëron 49 %** ( pesë përqind ) të kapitalit themeltar, që i korrespondon 1715 aksioneve, në shumën 1.715.000 (njëmilion shtatëqind pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

## Neni 8
## Zmadhim i kapitalit

8.1 Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve në përputhje me nenin 145 pika 1 e ligjit Nr. 9901 datë 14.04..2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

8.2 Kapitali mund të rritet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese. Aksionet e reja shlyhen me para në dorë ose me kontribut në natyrë.

8.3 Aksionarët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve për rritjen e kapitalit. E drejta e përparësisë ushtrohet në raport me aksionet që zotëron çdo aksionar në çastin e rritjes së kapitalit. Aksionarët mund të heqin dorë personalisht nga e drejta e nënshkrimit të aksioneve të reja.

8.4 Në rastin e rritjes së kapitalit me kontribute në natyrë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme caktohet një ekspert i autorizuar në përputhje me nenin 135 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04..2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

8.5 Rritja e kapitalit duhet të bëhet në përputhje të plotë të kërkesave të nenit 168 pika 4 e ligjit Nr. 9901 datë 14.04..2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

8.6 Administratori detyrohet të njoftojë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Vendimin për zmadhimin e kapitalit në përputhje me ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit "

8.7 Administratori njofton Qendrën Kombëtare të regjistrimit për zmadhimin e kapitalit që bëhet efektiv në datën e regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit sipas kërkesave të nenit 169 pika 3 dhe 4 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

## Neni 9
## Zvogëlimi i kapitalit

9.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, në përputhje me përcaktimet e nenit 145 pika 1 dhe nenit 181 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04..2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

9.2 Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës i cili duhet të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 149, pika 3 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04..2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ku vlefshmëria e vendimit të Asamblesë kushtëzohet nga

prania e aksionarëve të cilët zotërojnë më shumë se ½ e pjesës së kapitalit të shoqërisë. Vendimi i posaçëm për këtë çështje merret me miratimin e ¾ , që zotërojnë aksionet me përparësi të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje.

9.3 Vendimi i zvogëlimit të kapitalit i njoftohet për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga administratori në përputhje me ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007, neni 43 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ". Kapitali zvogëlohet duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit

**Neni 10**
**Shlyerja dhe Verifikimi i Kapitalit**

10.1 Kapitali themeltar i shoqërisë duhet të jetë shlyer plotësisht, në qoftë se realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para në dorë. Në rast të kundërt, rritja e kapitalit dhe emetimi i aksioneve të reja konsiderohen të pavlefshme.

10.2 Në rast të rritjes së kapitalit, Këshilli Mbikëqyrës duhet që brenda një afati 3 mujor nga zmadhimi i kapitalit të verifikojë depozitimin e kapitalit.

**Neni 11**
**Aksionet**

11.1 Aksionet mund të jenë zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në Asamblenë e Përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesët e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë.

11.2 Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin, që nga ndarja e disidenteve të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm , përpara shpërndarjes së fitimeve, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara në ligj në statut.

**Neni 12**
**Transferimi i Aksioneve**

12.1 Në rastin kur një aksionar dëshiron të transferojë të gjitha ose një pjesë të aksioneve të tij, është i detyruar të njoftojë me shkrim Këshillin Mbikëqyrës, duke i bërë të ditur vlerën e aksioneve me qëllim që aksionarët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Këshilli Mbikëqyrës njofton me shkrim aksionarët e tjerë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për një transferim të tillë.

12.2 Aksionarët e tjerë duhet të njoftojnë Këshillin Mbikëqyrës brenda 20 ditëve nëse ata do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo.

12.3 Në rast se numri i aksionarëve që dëshirojnë të blejnë aksione është më i madh se një, ata do të marrin aksione në përpjesëtim me numrin e aksioneve që zotërojnë. Transferimi i aksioneve, ndryshe nga sa është parashikuar në këtë nen do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk sjell pasoja ligjore për shoqërinë.

**Neni 13**
**Të Drejtat dhe detyrimet që lidhen me Aksionet**

13.1 Çdo aksion i jep të drejtën zotëruesit të tij të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë në raport me aksionet që përfaqëson dhe në rast likuidimi të drejtën e pjesëmarrjes në asetet e mbetura të shoqërisë.
13.2 Aksionarët janë përgjegjës deri në vlerën nominale të aksioneve të tyre.
13.3 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga aksionet ndjekin aksionet pavarësisht nga transferimi i tyre.

## KAPITULLI III
## ORGANET E SHOQËRISË

**Neni 14**
**Asambleja e Përgjithshme**

14.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i shoqërisë. Ajo vendos mbi të gjitha çështjet e shoqërisë dhe vendimet e saj janë detyruese për aksionarët.
14.2 Vetëm Asambleja e shoqërisë ka të drejtën të ndryshojë statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo kufizim tjetër është i pavlefshëm.
14.3 Asambleja e Përgjithshme merr të gjitha vendimet për çështjet që janë të parashikuara në nenin 135 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
14.4 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
14.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori, nga anëtarët e këshillit Mbikëqyrës sipas parashikimeve të nenit 136 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", apo nga aksionarët të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël të parashikuar në statut, ku të drejtat e këtyre aksionarëve janë të parashikuara në nenin 139 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",
14.6 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, ose edhe me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara ditës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Ky njoftim duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 137, pika 2,3,4 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",

**Neni 15**
**Rendi i ditës**

15.1 Rendi i ditës që u njoftohet aksionarëve sipas parashikimeve të nenit 137 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje .
15.2 Nëse asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit teksti i ndryshimeve duhet t'u njoftohet së bashku me rendin e ditës.
15.3 Administratori duhet t'i përgjigjet me shkrim çdo kërkese për sqarim për rendin e ditës , dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme
15.4 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të nenit 137 dhe 138 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",

**Neni 16**
**Përfaqësimi në Asamble**

16.1 Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.
16.2 Administratori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
16.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjen vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 17**
**Pjesëmarrja në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme**

17.1 Asambleja e përgjithshme përcakton rregulla për procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjen në asamble. Rregullat miratohen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e ¾ të kapitalit të përfaqësuar në mbledhje.
17.2 Gjatë mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre ku shënohen emrat dhe adresat e secilit së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave që këto aksione japin vlerën nominale të aksioneve si dhe llojin apo kategorinë e tyre të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

**Neni 18**
**Procesverbalet e mbledhjeve të asamblesë**

18.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
18.2 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

**Neni 19**
**Vlefshmëria e Vendimeve**

19.1 Në rastin e çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm

ose të përfaqësuar të gjithë aksionarët që zotërojnë më shumë se 30 % të aksioneve, me të drejtë vote.

19.2 Kur asambleja duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar,, mund të merren vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë në votim të gjithë aksionarët.

19.3 Në rast se asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

**Neni 20**
**E drejta e Informacionit**

20.1 Administratori është i detyruar të vërë në dispozicion të aksionarëve ne mbledhjen e Asamblesë të gjitha dokumentet që parashikon ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

20.2 Çdo aksionar ose përfaqësues i tij ka të drejtën të marrë informacion mbi të gjitha çështjet e parashikuara në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në selinë e tyre duke filluar nga momenti i marrjes njoftim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Në mënyrë të veçantë, ata kanë të drejtën për të marrë informacion për :

- Regjistrat, bilancet, listat e personelit administrativ dhe të këshillit Mbikëqyrës
- Raportet e administratorit, të këshillit Mbikëqyrës dhe Eksperti Kontabël të autorizuar
- Shumën e saktë të shpërblimeve të personave të mësipërm

20.3 Çdo aksionar ka të drejtën të marrë informacion ose kopje të listës së aksionarëve dhe të Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

20.4 Nëse shkelet e drejta për të marrë informacion e aksionarëve, ata kanë të drejtën t'i drejtohen gjykatës.

**Neni 21**
**Kërkesa për të marrë pjesë në Mbledhje**

21.1 Aksionarët që duan të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme duhet të paraqesin aksionet ose vërtetimin që zotërojnë aksione të shoqërisë

**Neni 22**
**Pjesëmarrës të tjerë**

22.1 Anëtarët e këshillit Mbikëqyrës, administratori dhe eksperti kontabël mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së përgjithshme të Aksionarëve dhe kanë vota konsultative. Nëse ata janë aksionarë, vota e tyre është vendimtare.

**Neni 23**
**Librat**

23.1 Emrat e atyre që marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve regjistrohen në "Librin e Pjesëmarrësve"
23.2 Për mbledhjet mbahet procesverbal

**Neni 24**
**Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës**

24.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve drejtohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ose në mungesë të tij nga zëvendësi ose një person i zgjedhur nga anëtarët e pranishëm

**Neni 25**
**Këshilli Mbikëqyrës**

25.1 Këshilli Mbikëqyrës është organi që drejton shoqërinë. Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të emëruar nga Asambleja e përgjithshme e Aksionarëve. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë janë :

1. **Z. Ajdin Sejdiu**, i biri i Brahimit dhe Zejnijes, lindur më 21.09.1951 në fshatin Grabanicë , Kosovë dhe banues në Rruga " Dëshmorët 4 Shkurti" shkalla 1, ap. 16 Tiranë me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar sipas pasaportës me Nr. KD 0386145. (Kryetar )
2. **Z. Molos Dabaj**, i biri i Gjokws dhe i Fotinisw, lindur më 04.08.1979 në Klos, Mat dhe banues në adresw: Rruga "Aleksandwr Goga", Lagjja Nr. 8, Durrws, identifikuar sipas kartës së identitetit me Nr 030469286. ( anëtar )
3. **Z. Sami Vrapi**, i biri i Ibrahimit dhe i Fatimes, lindur më 12.03.1956 në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rruga: BLV "Bajram Curri" BN. 70 H. 2 , identifikuar sipas kartës së identitetit me Nr. 025677134 ( anëtar )

25.2 Anëtarët e këshillit Mbikëqyrës të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme mund të jenë ose të mos jenë të punësuar në shoqëri.
25.3 Kryetar i këshillit Mbikëqyrës është z. AJDIN SEJDIU.

**Neni 26**
**Anëtarët**

26.1 Nuk mund të zgjidhen administratorët e shoqërisë Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës si dhe personat e lidhur me ta sipas parashikimeve të nenit 13, pika 3 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
26.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk duhet të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë të pavarur
26.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikën 1 shkronja "b" deri në "g" e "i" dhe 2 të nenit 154 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
26.4 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh e cila mund të përsëritet dhe për një periudhë tjetër me vendim të

Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të thirrur për miratimin e deklaratave financiare të vitit financiar që u mbyll.

26.5 Këshilli Mbikëqyrës cakton një kryetar dhe zëvendësin e tij. Kryetari dhe në mungesë të tij, zëvendësi, drejton mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.

26.6 Në rast vdekjeje, largimi ose mungesë të paarsyeshme nga tre mbledhje të njëpasnjëshme, këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një zëvendës deri në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Aksionarëve.

**Neni 27**
**Mbledhjet**

27.1 Këshilli Mbikëqyrës mblidhet nga Kryetari ose në mungesë të tij nga të paktën dy anëtarë të tij.

27.2 Këshilli Mbikëqyrës ka një shumicë dhe mblidhet ligjërisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar 50 për qind plus një e anëtarëve të tij. Anëtarët që mungojnë nga Këshilli Mbikëqyrës mund të përfaqësohen vetëm nga një anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës.

**Neni 28**
**Vendimet**

28.1 Diskutimet dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen në procesverbale të cilat firmosen nga Anëtarët e pranishëm së bashku me mendimet e kundërta të atyre që nuk janë dakord.

28.2 Këshilli Mbikëqyrës ka kompetencën të vendosë për të gjitha çështjet e drejtimit të shoqërisë, administrimin e pasurive të saj dhe realizimin e qëllimeve të shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës nuk ka të drejtë të vendosë për çështjet të cilat janë në kompetencë të Asamblesë së Aksionarëve.

28.3 Këshilli Mbikëqyrës mund të delegojë me shkrim përfaqësimin e shoqërisë dhe/ose të kompetencave të saj tek një ose disa anëtarë ose palë të treta, duke përcaktuar dhe kompetencat e deleguara.

28.4 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfitojnë shpërblim, i cili vendoset nga Asambleja e Aksionarëve.

**Neni 29**
**Administratorët**

29.1 Administrator i shoqërisë emërohet z. **Remzi Hoti.**

29.2 Administratorët mund të jenë ose të mos jenë aksionarë në shoqëri dhe nuk duhet të jenë Anëtarë të këshillit mbikëqyrës. Administratorët janë persona fizikë.

**Neni 30**
**Mandati i Administratorit.**

30.1 Administratori qëndron në detyrë për një periudhë prej 3 ( tre) vjetësh me të drejtë rizgjedhje.

30.2 Këshilli Mbikëqyrës për shkaqe të arsyeshme mund të shkarkojë Administratorët

## Neni 31
## Funksionimi

31.1 Shoqëria në marrëdhënie me të tretët përfaqësohet nga Administratori

## Neni 32
## Kompetencat

32.1 Administratori ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, përveç atyre kompetencave që ushtrohen nga Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli Mbikëqyrës.

32.2 Administratori ushtron kompetencat brenda kufijve të objektit të shoqërisë

32.3 Në rast të transaksioneve që kërkojnë autorizimin e këshillit Mbikëqyrës dhe ky i fundit nuk e jep atë, Administratori mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme dhe t'ia paraqesë çështjen për shqyrtim.

32.4 Administratori përgatit raportet dhe rendin e ditës së mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe këshillit Mbikëqyrës.

32.5 Administratori, brenda 3 muajve nga dita e mbylljes së vitit financiar, përgatit dhe i paraqet Këshillit Mbikëqyrës llogaritë vjetore dhe raportet vjetore të veprimtarisë financiare të shoqërisë për t'i verifikuar dhe kontrolluar.

## Neni 33
## Drejtori Teknik

**33.1** Asambleja e Përgjithshme emëron Drejtorin Teknik të shoqërisë z. Roman Stiplovsek, i biri i Stadzos, i datlindjes 26.12.1972, lindur në Slloveni dhe banues në Lagje Nr. 13, Rruga: "Bajram Curri", Plazh, Durrës, me kartë identiteti nr. 2612972500022, lëshuar nga Republika e Sllovenisë në datë 28.03.2012.

# KAPITULLI IV
# KONTROLLI I SHOQËRISË

## Neni 34
## Ekspertët Kontabël

34.1 Asambleja e Përgjithshme emëron ekspertët kontabël të cilët kanë të drejtën të :

- Ndihmojnë në mbajtjen e llogarive me qëllim që të jenë në përputhje me veprimet kryesore të kontabilitetit;
- Përgatitin raportet vjetore me të dhënë ekonomike (bilancet, llogaritë e fitimit dhe humbjeve dhe dokumente të tjera që lidhen me to) dhe japin mendimet e tyre nëse të dhënat ekonomike reflektojnë gjendjen ekonomike aktuale të shoqërisë .
- Informon Këshillin Mbikëqyrës mbi çdo parregullsi të mundshme të vënë re në procedura, asetet e shoqërisë që mund të kenë shkaktuar humbje për shoqërinë.
- Ekspert kontabël i shoqërisë caktohet Hazbie Leka, me licencë profesionale Nr. 118, e regjistruar pranë QKR si eksperte kontabël e Kompanisë "Sky Master Projekt Holding" sha.

## Neni 35

**Kompetencat**

35.1 Ekspertët kontabël qëndrojnë në detyrë për periudhë prej 1 (një) viti, ose më tepër.
35.2 Eksperti kontabël është i detyruar të mbikëqyrë llogaritë vjetore të jenë të përpiluar në përputhje me ligjin " Për Kontabilitetin" dhe përmbajnë rezultatet e periudhës ushtrimore dhe japin rezultatin e plotë të vitit financiar që u mbyll.
36.3 Nëse eksperti kontabël nuk i kryen detyrat e tij siç duhet, ai mund të pezullohet nga detyra me vendim gjykate.

**Neni 36**
**Librat e Shoqërisë**

36.1 Shoqëria duhet të mbajë librat e kërkuar nga ligji në të cilët regjistrohen llogaritë vjetore, deklaratat financiare vjetore, bilancet vjetore, raportet ekonomike vjetore të cilët duhet të përmbajnë çdo gjë që parashikohet nga ligji.
36.2 Librat e shoqërisë si dhe pasqyrat financiare, bilancet vjetore dhe raportet financiare vjetore mbahen në gjuhën Shqipe.

**Neni 37**
**Viti Financiar**

37.1 Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 muajsh duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
37.2 Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr llogaritë vjetore që të jenë në përputhje me ligjin " Për Kontabilitetin" dhe harton raportin mbi administrimin.

**Neni 38**
**Rezerva e domosdoshme ligjore**

38.1 Rezerva e domosdoshme ligjore krijohet nga të paktën 5 përqind e fitimit neto që mbetet pas zbritjes së humbjeve të viteve të kaluara. \një procedurë e tillë nuk është e detyrueshme kur fondi rezervë bëhet sa 1/10 e kapitalit aksionar.

**Neni 39**
**Ndarja e Fitimit**

39.1 Fitimi llogaritet si rezultat i fitimit të bilancit duke i zbritur rezervën e domosdoshme dhe humbjet e viteve të kaluara sipas ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**Neni 40**
**Dividendët**

40.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe llogaritjen e shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën që do t'u jepet aksionarëve si dividend në bazë të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## KAPITULLI V
## SHPËRNDARJA

### Neni 41
### Shpërndarja

41.1 Shoqëria aksionare prishet sipas shkaqeve të parashikuar në nenin 187 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe me mbarimin e objektit ose të parashikimeve të veçanta në statut.

### Neni 42
### Likuidimi

42.1 Shoqëria likuidohet në përputhje me dispozitat ligjore për falimentimin.
42.2 Shoqëria bën likuidimin në çastin e prishjes së saj për çfarëdolloj arsyeje.
42.3 Gjatë likuidimit, emri i shoqërisë ndiqet nga shprehja " në likuidim". Ky emër si dhe emri i likuidatorit duhet të pasqyrohen në të gjitha veprimet dhe dokumentet e ;lëshuara nga shoqëria tek të tretët.
42.4 Likuidimi i shoqërisë bëhet sipas neneve 190 deri 205 të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

## KAPITULLI VI
### Neni 43
### Dispozita të Përgjithshme

43.1 Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
43.2 Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi iu lexua aksionarëve dhe u pranua vullnetarisht prej tyre dhe u nënshkrua prej tyre.

**AKSIONARËT**

**AJDIN SEJDIU**

**REMZI HOTI**

**DREJTORI TEKNIK**

**ROMAN STIPLOVSEK**

# SIGNATORY COPY OF PASSPORT


Organi kompetent që lëshon pasaportën
Надлежни орган који издаје пасош
Passport-issuing authority

PASAPORTË - ПАСОШ - PASSPORT KOSOVA - КОСОВО - KOSOVO

P
RKS
K00386145
SEJDIU
AJDIN
GRABANICË
21.09.1951
M
180 cm
MINISTRY OF
1170570894
02.07.2009

P<RKSSEJDIU<<AJDIN<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<
K003861455RKS5109218M1907014117057089 4<<<<04


REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA
Hoti
Remzi
Shqiptare/Albanian
030610302
Qerret,Durres
M
22-01-1967
26-01-2011
25-01-2021
G70122171D


I<ALB0306103027G70122171D<<<<<
6701228M2101255ALB<<<<<<<<<<<8
HOTI<<REMZI<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<

REPUBLIKA SLOVENIJA

Žalec

Savinjska cesta 006

Potni list
Passport · Passeport

REPUBLIKA SLOVENIJA

P SVN

Stiplovšek

Roman

P B05747...

Slovenije

26.12.1972 2612972500022

M Celje

28.03.2012 UE Žalec

28.03.2022



P<SVNSTIPLOVSEK<<ROMAN<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<<

PB05747948SVN7212262M22032852612972500022<64




I<ALBD30469786BH908D4056F<<<<<
79D8046M2012294ALB<<<<<<<<<<<0
DABAJ<<MOLOS<<<<<<<<<<<<<<<<<<



REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA

Vrapi

Sami

Shqiptare/Albanian

024443989

Bathore, tirane

12-03-1956

M

25-02-2009

24-02-2019

MB

F603121506



I<ALB0244439899F603121506<<<<<
5603129M1902248ALB<<<<<<<<<<<5
VRAPI<<SAMI<<<<<<<<<<<<<<<<<<<

# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE (IEKA)

# LICENSE

*Kjo license i leshohet*, Hazbie Nazmi Leka

*per te ushtruar profesionin e* **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR**.

*Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A. dhe mban numrin:* 112, *sipas kesaj liste.*

**PRESIDENTI**

(... Bakiu ...)

*Leshuar me,* 5 ...

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE     *Studio Noteriale Fatmir Laçej*

Nr. 5130 Rep.

# VERTETIM

*Vertetoj se sot me date 05/04 2012, para meje Fatmir Laçej, noter ne qytetin e Tiranes, me zyra ne Rr. e Kavajes, Pall.203 u paraqit personalisht z./znj. ........ Sami Vrapi ........ madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit/te ciles u sigurova nga dokumenti i tij/i saj personal,i cili/e cila kerkoi nga une noteri vertetimin me origjinalin te dokumentit te fotokopjuar, bashkelidhur,*

*Dokumenti permban ..1..... faqe dhe eshte fotokopjuar per tu perdorur sipas nevojes dhe vetem sipas kerkesave te ligjit.*

***Pas krahasimit dhe verifikimit te permbajtjes se dokumentit te fotokopjuar me origjinalin e paraqitur , personit qe paraqiti dokumentin.......... Licence .................... ju be e qarte pergjegjesia penale dhe sanksionet ligjore ne ngarkim te tij/saj ne rast prodhimi, paraqitje apo perdorimi te nje dokumenti te rreme apo te falsifikuar, pa marre vete noteri pergjegjesine per rregullshmerine e permbajtjes se aktit.***

*Une noteri pasi bera verifikimin e origjinalit me fotokopjen, konstatova se fotokopja e dokumentit eshte e rregullt ,pa fshirje,korrigjime apo shlesa dhe e vertetoj ate ne baze te Nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" me ndryshimet perkatese dhe pikes 3,4,7 te Udhezimit te Ministrit te Drejtesise Nr.6291 date 17.08.2005.*

*NOTERI*

Fatmir Laçej

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE